



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0924

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Internat Security Association” SH.P.K. kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “Agjencia Qendrore e Prokurimit” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve te APRK-se” me numër të prokurimit:UA/2016-25-6709-2-1-1, me 05/11/2025, mori:

Vendim

1.Hedhet si e palejuar, ankesa e “Internat Security Association” SH.P.K. me nr. të protokollit 2025/0924, e datës 18/09/2025, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve te APRK-se”, me numër të prokurimit UA/2016-25-6709-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Agjencia Qendrore e Prokurimit”

2.Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.07.2025, “Agjencia Qendrore e Prokurimit” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve te APRK-se” me numër të prokurimit: UA/2016-25-6709-2-1-1. Ndërsa me datën 05.09.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues

ku ka shpërblyer me kontratë OE “KSF Major” SH.A. ne shumen prej 146,040.00.

Me 08.09.2025 OE “Internat Security Association” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18.09.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Internat Security Association” SH.P.K. me nr. 2025/0924 lidhur me aktivitetin “Shërbimet e sigurimit fizik te objekteve te APRK-se” me numër të prokurimit: UA/2016-25-6709-2-1-1

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Internat Security Association” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

1. Autoriteti Kontraktues Autoriteti Qendror i Prokurimit (tutje referuar si AK), me datë 24.07.2025 ka shpallur njoftimin për kontratë në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: Shërbimet e sigurimit fizik, të objekteve të APRK-së, me numër të prokurimit UA/2016- 25-6709-2-1-1. 2. Njoftimi për kontratë është bërë në platformën e prokurimit elektronik (e-prokurimi). 3. Operatori ekonomik International Security Association SH.P.K., përmes platformës së prokurimit elektronik ka shkarkuar dosjen e tenderit me numër dhe titull të specifikuar si më lartë (tutje referuar si DT). 4. Në dosje të tenderit në ANEKSI 1, AK ka kërkuar të respektohen dispozitat ligjore të ligjit të punës, punëtorët të lajmërohen në ATK, të paguhën kontributet penasionale dhe kërkesat tjera si dhe të respektohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për pagën minimale. 2 Më këtë rast AK ka kërkuar respektimin e dispozitave të ligjit të punës, pasi që është evidente se Ligji nuk mund të respektohet parciaisht, por ç’do Operator Ekonomik e ka për obligim respektimin e dispozitave ligjore në tërësi. - Provë: Dosja e tenderit, ANEKSI 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme Me datë 08.08.2025, brenda afatit të përcaktuar sipas dispozitave ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik, OE ka parashtruar pyetje drejtuar AK, të cilat i ka ngarkur në platformën e e-prokurimit, për të sqaruar kushtet e tenderit, ku OE ankues i ka parashtruar dy pyetje të cilat kanë të bëjnë me nivelin e pagës minimale dhe respektimin e Ligjit të Punës: Pyetja 1: Kërkojmë që të na jepni përgjigjet lidhur me sqarimet e kërkuara në mënyrë që do të na ndihmoj në përgatitjen e ofertës sonë (çmimit përfundimtar). Përgjigja e AK: Lidhur me pyetjen e parë, që paga nuk është kërkesë në dosjen e tenderit. Por kjo çështje është e rregulluar me ligjin e pagave dhe vendimin e Qeverisë për pagën minimale. Ju informojmë se duhet respektuar te gjitha ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Pyetja 2: Gjate implementimit te kontrates a duhet te respektohet Ligji Nr. 03/L-212 i Punës dhe Ligji Nr. 08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë? Përgjigja e AK: Ndërsa, sa i përket pyetjes së dytë, po, gjatë implementimit të kontratës, duhet të respektohen ligjet përkatëse për Shërbimet Private të Sigurisë. Ju informojmë se duhet respektuar te gjitha ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës 5. Pra përgjigja e AK në pyetjet e parashtruara nga OE ankues ka qenë se “Duhet të respektohen të gjitha ligjet e aplikueshme në fuqi”. 6. AK ka publikuar pyetjet dhe përgjigjet në platformën e prokurimit elektronik ka në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. - Provë: Pyetja e parashtruar nga OE dhe përgjigjet nga AK datë

08.08.2025. 7. OE Internat Security Association, duke u bazuar në specifikat e dosjës së tenderit, kriteret e kërkuara nga AK në dosje të tenderit, si dhe duke u bazuar në Sqarimet shitesë – përgjigjet në pyetjet e AK, ka përpiluar ofertën financiare për të ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit, duke respektuar kërkesat e dosjës së tenderit dhe dispozitat ligjore sipas rekomandimit të AK në sqarimin e dhënë në përgjigjet në pyetje të parashtruara nga OE ankues.

3 8. AK përmes njoftimit së datës 05.09.2025, ka shpërblyer me kontratë OE “KSF MAJOR SH.A.”, i cili ka ofertuar me një çmim prej 146,040.00 €, ndërsa OE Ankues e ka shpallur të pa suksesshëm me pretendimin se nuk ka qenë tenderi me çmimin më të ultë në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

9. OE Ankues, brenda afatit ligjor me datë 08.09.2025, në pajtim me Nenin 108/A par.1 nënpar. 3.2., ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndaj Vendimit të AK, mirëpo e njëjta kërkesë është refuzuar si e pabazuar.

10. Edhe pse AK ka kërkuar respektimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për pagën minimale, si dhe ka kërkuar të respektohet Ligji i punës për pagesa ndaj punëtorëve, të cilat kriteret i ka theksuar edhe në sqarimin e pyetjeve të parashtruara. Poashtu edhe përkundër faktit se OE ankues në ofertë si dhe në Ankesën e parashtruar ndaj vendimit të AK ka bashkëngjitur edhe tabelen financiare – Analizën e cila tregon mënyren e kalkulimit të pagës sipas ligjit, dhe e cila vërteton se OE i shpallur fitues nuk i plotëson kriteret, AK nuk i ka marrë përbazë këto kriteret të cilat vet i ka caktuar, si dhe nuk i ka marrë për bazë dispozitat Ligjore të Ligjit të Punës dhe ligjeve tjera relevante si dhe akteve nënligjore të cilat janë obligative për secilin që të respektohen pa asnjë dyshim, në të kundërtën shkelja e ligjit konsiderohet vepër e cila ndiqet edhe penalisht. - Provë: Analiza financiare

11. Për shkak që do të theksojmë më poshtë këtë kërkesë për rishqyrtim, OE Ankues konsideron se, AK me rastin e marrjes së këtij vendimit për shpërblyer me kontratë dhe vendimit për refuzim të ankesës së OE Ankues ka bërë shkelje të: 1.1. Nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim / Jo – diskriminimi), 1.2. Nenit 53 të LPP-së (Sigurimi i informatave shtese për kandidatët dhe tenderuesit) 1.3. Neni 59 par.3 dhe 4 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve), 1.4. Neni 60 i LPP-së (Kriteret për Dhënie të Kontratës) 1.5. Neni 61, par. 2 i LPP-së (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët) 1.6. Nenin 41.5. pika (b) dhe Nenin 41.8. pika (ii) të RRUOPP-së, 1.7. E të gjitha këto shkelje të dispozitave të theksuara më lartë në mënyrë direkte janë të ndërlidhura dhe paraqesin shkelje të Nenit 6 të LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti). 1.8. Vendimin e Kryeministrit rreth Pagës Minimale në Republikën e Kosovës dhe 1.9. Dispozitat Ligjore të Ligjit të Punës Ligji Nr. 03/L-212 II. Lidhur me shkeljet e dispozitave të LPP-së

10. AK me rastin e shpërblyerimit me kontratë të OE fitues, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, për shkak se OE fitues është dashur të shpallet i papërgjegjshëm sepse oferta e tij nuk ka qenë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen të tenderit, e që në rastin konkret vendimi për të shpallur fitues një OE të papërgjegjshëm përmban shkelje të dispozitave të LPP-së dhe RRUOPP-së.

4 11. OE fitues “KSF Major SH.A.” është dashur që të shpallet si i papërgjegjshëm nga ana e AK-së, për shkak se: Ø Kalkulimi i pagës, nuk është bërë duke i'u përbajtur kërkesave të parashtruara në njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe sqarime të bëra nga AK; Ø Poashtu çmimi i ofruar nga OE i shpallur fitues, është kundërshtim me Nenin 55, 56, 57, 58 dhe 59 të Ligjit të Punës Ligji Nr. 03/L-212, si dhe Ø Vendimin e Qeverisë për pagën minimale në Republikën e Kosovës. Vendimi Nr. 02/218 Datë: 28.08.2024 II.1. Lidhur me

kalkulimin e pagës bruto në kundërshtim me njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe sqarimet e AK-së 12. OE fitues, nuk i është përmbajtur kërkesave të parashtruara në njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe sqarimeve të dhëna nga AK, sa i përket kërkesës së kalkulimit të pagës bruto të punëtorëve për një muaj. Bazuar në sqarimin të cilin e ka dhënë AK, në përgjigjet e pyetjeve për sqarim, ka kërkuar nga OE tenderues, që duhet të respektohen të gjitha ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës si dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për nivelin e pagës minimale. 13. OE International Security Association, ju ka përmbajtur në përpikëri kriterit të kërkuar nga AK dhe sqarimit të dhënë përmes përgjigjeve në pyetjen tonë. Bazuar në këtë në kemi llogaritue çmimin e ofertës, duke i respektuar kërkesat në dosje të tenderit, sqarimin në përgjigje të AK dhe Dispozitat Ligjore, ku vet AK ka kërkuar që të respektohen dispozitat Ligjore të Ligjit të Punës dhe gjitha ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. 14. Edhe përkundër faktit se AK në përgjigjet në pyetje, ka kërkuar respektim të dispozitave ligjore, këtë kriter nuk e ka respektuar gjatë vlerësimit të ofertave, por ka rekomanduar për kontratë OE i cili ka ofruar çmimin më të cilin nuk mundet në asnjë mënyrë të mbulojë kërkesat sipas ligjit, që sipas LPP-së duhet të konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme. Me ofertën e paraqitur nga OE fitues pa asnjë mëdyshje vërtetohet se oferta e tillë nuk është në përputhje me këtë kërkesë, sepse çmimi i ofertuar në raport me orët e punës të parashikuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nuk është real dhe i kalkuluar në bazë të kërkesave të parashtruara nga AK. 13. Sikur OE fitues të kishte respektuar kërkesat në lidhje me pagën minimale bruto prej 350.00 € për një punëtor të sigurimit, sipas Vendimit të Qeverisë për pagën minimale në nivel vendi, si dhe sikur ti kishte marrur perbazë edhe kërkesat e Ligjit të Punës për llogaritjen e pagës dhe kërkesave tjera si orët e natës plus 30%, orët e vikendit dhe festave +50%, poashtu edhe llogaritjen e pagesës së pushimit vjetor, kriteret këto të cilat janë bazike dhe 5 obligative për secilin biznes, atëherë oferta e tij nuk do të ishte në asnjë rrethanë kaq e ultë sepse një gjë e tillë është tërësisht e pamundur nëse do të respektoheshin kërkesat e parashtruara sa i përket pagës bruto. 14. Për të vërtetuar deklaratën tonë, ne kemi bashkëngjitur në ofertë edhe tabelën për llogaritjen e çmimit, e cila e tregon saktë se sa mund të jetë çmimi minimal bazuar në kërkesat e tenderit të shpallura nga AK dhe kërkesat e Ligjit të Punës dhe vendimin e Qeverisë për pagën minimale. - Provë – tabela e llogaritjes së çmimit dhe pagës për punëtor. 15. Me këtë veprim, AK ka shkelur Ligjin e Prokurimit publik, respektivisht: Neni 7 Barazia në trajtim/Jo diskriminimi; për faktin se kërkesat dhe përgjigja e AK e dhënë në sqarimin shtesë në bazë të pyetjeve të parashtruara nga OE ankues, kanë qenë kërkesa për respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit të Punës, ndërsa vlerësimi i ofertave është bërë në kundërshtim me kërkesat e vet AK. Në këtë formë janë lajthitur OE sepse në njërin anë përmes kriterëve në dosje të tenderit dhe sqarimin në pyetjet e parashtruara është kërkuar respektimi i Ligjit të Punës, ndërsa në anën tjetër me rastin e vlerësimit të Ofertave, AK nuk i është përmbajtur asnjë kriteri, vetëm ka përcaktuar çmimin më të ulët, duke mos e analizuar se ky çmim a i plotëson kriteret e dosjës së tenderit dhe kërkesat e AK. Neni 53 Sigurimi i informativ shtesë për kandidatet dhe tenderuesit. AK ka dhënë informata shtesë në përgjigjet e pyetjeve të parashtruara nga OE, por nuk ju ka përmbajtur këtyre përgjigjeve – kërkesave gjatë vlerësimit të ofertave të OE. Neni 57 Sqarimi i tenderit; AK nuk ka marrë për bazë informatat të cilat i ka shpërndrë tek OE me rastin e përgjigjeve në pyetjet e parashtruara, por vlerësimin e tenderit e ka bërë në kundërshtim me përgjigjet e pyetjeve të

cilat i kë dhënë. Më këtë nuk ka bërë krahasim të ofertave sipas procedurave dhe sipas ligjit. Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve: par 4 i LPP-së, sepse në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me këtë nen, ka shpallur fitues OE i cili nuk i plotëson kriteret sipas dosjës së tenderit. Si dhe ka shpallur të pasuskeshtëm OE INTERNAT SECURITY ASSOCIATION, edhe pse i plotëson kriteret sipas ligjit. Nëse AK gjatë Ekzaminimit, Vleresimit dhe Krahasimit të Tendereve do ti përmbahej AK kriteretve të dosjës së tenderit si dhe dispozitave ligjore të Ligjit të Punës për kalkulimin e pagës duke u bazuar edhe në Vendimin e Qeverisë për pagën Minimale, atëherë atëherë do duhej që të shpallte të papërgjegjshme ofertat financiare të OE te cilët nuk i janë përmbajtuar kriteretve sipas dosjës së tenderit dhe nuk i kanë respektuar Dispozitat ligjore të Ligjit të Punës. Neni 60 Kriteret për dhenien e kontrates; edhe pse AK ka përcaktuar kriteret të kontratës respektimin e të gjitha ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe Ligjin e punës për pagën minimale dhe kërkesat e dala nga ligji, vet AK, nuk e ka respektuar këtë kriter, 6 por ka rekomanduar për dhenie të kontrates OE, i cili nuk i plotëson as për se afërmi këto kriteret. Neni 61 Tenderte Jo-Normalisht të Ulët: AK nuk e ka vlerësuar ofertën financiare të OE të shpallur fitues në frymën e Nenit 61, ku bazuar në këtë Nen, OE i shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret sipas dosjes së tenderit dhe dispozitave ligjore, prandaj AK është dashur që OE e shpallur fitues ta eliminojë mbi bazën e këtij Neni, si dhe ofertat tojera të cilat me ofertën financiare nuk i plotësojnë kriteret dhe nuk i respektojnë dispozitat ligjore të Ligjit të punës. 15. Andaj AK me rastin e shpërblimit me kontratë të OE fitues, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, për shkak se OE fitues është dashur të shpallet i papërgjegjshëm në kuptim të Nenit 59 par.4 të LPP-së lidhur me Nenin 41.4. pika (b) të RRUOPP-së, sepse oferta e tij nuk ka qenë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen të tenderit. Neni 59 par.4 i LPP-së thotë: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Neni 41.4. pika (b) e RRUOPP-së thotë: Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur është në pajtueshmëri me termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit. II.2. Lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe Vendimit të Qeverisë së Kosovës për pagën minimale në nivel vendi 16. Po ashtu, AK me rastin e shpalljes fitues të OE “KSF Major Security SH.A.”, ka nuk ka marrur për bazë Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës, i cili është obligativ për të gjitha bizneset dhe duhet të respektohet në përpikëri: Neni 57. Paga Minimale, par 1 dhe 2 . i Ligjit të Punës thotë: 1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuarit ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës. 2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë: 2.1. 20 % në orë për kujdestari; 2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës; 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit; 2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës. 3. Paga minimale përcaktohet në bazë të orëve të punës, për periudhën një (1) vjeçare, e cila publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. 7 4. Paga minimale mund të përcaktohet me marrëveshje në nivel kombëtar, në nivel dege dhe në nivel të ndërmarrjes, por që nuk duhet të jetë më e ulët se paga minimale e paraparë në paragrafin 1. të këtij neni. Neni 58. Kompensimi i pagës, par 1 i Ligjit të Punës thotë: 1. I

punësuari ka të drejtë për kompensim në pagë, në rastet si në vijim: 1.1. gjatë ditëve të festave në të cilat nuk punohet; 1.2. gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor; 1.3. gjatë aftësimit dhe përsosjes profesionale për të cilën është dërguar, dhe 1.4. gjatë ushtrimit të funksioneve publike për të cilat nuk paguhet. Neni 32. Kompensimi i pushimit vjetor, par 1 i Ligjit të Punës thotë: I punësuari gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar. Neni 59. Kompensimi i pushimit mjekësor, par 1 i Ligjit të Punës thotë: I punësuari në rast të sëmundjes ka të drejtë në pushim mjekësor të rregullt mbi bazën, deri në njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti me kompensim prej 100 % të pagës. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 02/218, datë 28.08.2024, ka përcaktuar Shumën e beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale. Pika 1 e këtij vendimi thotë: Neni 60. Kompensimi i pushimit mjekësor, par 1 i Ligjit të Punës thotë: Pika 1 e vendimit: Aprovohet propozimi i Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për përcaktimin e pagës minimale në Republikën e Kosovës, në nivelin prej 2.00 € (dy euro) për një orë pune të rregullt, apo 350.00 € (treqindpesëdhjetë euro) bruto në muaj për punë me orar të plotë. Pika 2 e vendimit: Paga minimale e përcaktuar në pikën 1 fillon të zbatohet nga data 1 tetor 2024. Andaj nga gjendja faktike të cilën e kemi pasqyruar në këtë ankesë, lehtësisht mund të kuptohet se AK ka shpërblyer me kontratë OE i cili nuk i plotëson as për së afërmi kushtet dhe kriteret e përcaktuar në dosje të tenderit dhe sqarimet nga AK në procedurë. 17. OSHP duhet ta ketë parasysh edhe faktin se, AK nuk ka marrë për bazë asnjë kriter të përcaktuar në dosje të tenderit dhe sqarimin e dhënë në pyetjet të cilat i kemi parashtruar për të sqaruar dosjen dhe kriteret e tenderit. III. PËRFUNDIM 8 I tërheqim vëmendjen OSHP-së se, AK me rastin e vlerësimit të ofertave të OE të cilët kanë konkuruar në këtë proces të prokurimit, ku ka marrë vendim për shpërblyer me kontratë OE fitues me çmimin më të ulët, pas asnjë kriter dhe pa asnjë bazë ligjore. Në të njëjtën kohë ka marrë vendim ta shpallë të pasusesshëm e OE Internat Security Association, me arsyetimin se çmimi i ofruar nuk është çmimi më i lirë, duke mos e marrur për bazë se oferta jonë është në përputhje me Kërkesat sipas Dosjes së tenderit, Sqarimin e dhënë nga AK në përgjigjet e pyetjeve; në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës si dhe Vendimit të Qeverisë së Kosovës për pagën minimale. Poashtu e ka hedhur poshtë Kërkesën për Rishqyrtim, të cilën OE Internat Security Association e ka parashtruar pranë AK, duke u bazuar në fakte dhe prova të bazuara dhe të besueshme. AK ka bërë shkelje për shkak se OE fitues dhe OE ankues nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë. AK është dashur të eliminojë OE të cilët me ofertat e tyre financiare nuk i plotësojnë kërkesat të cilat i kemi thekuar më lartë, konform dopsjes së tenderit dhe dispozitave ligjore. Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte të argumentuara më lartë në këtë ankesë, konsiderojmë se, AK ka marrë vendim të kundërligjshëm për shkak se: · AK ka bërë trajtimin diskriminues dhe të pabarabartë të operatorëve ekonomik; · AK ka shpërblyer me kontratë një OE të papërgjegjshëm, sepse oferta e tij nuk ka qenë në përputhshmëri me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit sa i përket kalkulimit të pagës bruto prej 350.00 € për një punëtor dhe kërkesave tjera të dala nga ligji

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19/09/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0924/25, ndërsa me datë 30/09/2025 është dorëzuar

raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2025/0924 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues është pajtuar, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Internat Security Association” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0924 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues jep mendimin e tij në lidhje me pretendimin ankimor, pasi ka administruar dhe shqyrtuar me kujdes shkresat që lidhen me faktet dhe argumentet në platformën elektronike e – prokurimi, eksperti shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron.

Me qëllim të pasqyrimin të plotë të gjendjes faktike, eksperti shqyrtues ka administruar si prova raportin e komisionit të vlerësimit të ofertave, njoftimin mbi vendimin e autoritetit Kontraktues - (AK) së bashku me Letrat Standarde për Tenderuesit e Pasuksesshëm si dhe materialin i cili gjendet në platformë, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Andaj, eksperti shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave dhe pasqyrimin të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik ankues duhet të hedhet si e palejuar. Rrjedhimisht eksperti shqyrtues ka vënë re që ankesa e OE të hedhet si e palejuar sepse i njëjti pas administrimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se OE ankues të konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4.1.26, të LPP-së, për faktin se, oferta e tij renditet e gjashta (6) apo e fundit për nga çmimi si OE i përgjegjshëm (pasuksesshëm) sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të

Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, e ka trajtuar ankesën e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Paneli shqyrtues lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e provës raportit lidhur me konstatimit me palën pa interes juridik, si në vijim “Eksperti Shqyrtues, OE ankues të konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4.1.26, të LPP-së, për faktin se, oferta e tij renditet e gjashta (6) apo e fundit për nga çmimi si OE i përgjegjshëm (pasuksesshëm) sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së” .

Andaj, sipas Nenit 4 pika 1.26 i LPP-së dhe Njoftimit të OSHP-së të datës 09.02.2023 (të publikuar ne ueb faqen e OSHP), OE ankues nuk ka atakuar edhe OE 4 (katër) OE tjerë të renditur para tij të cilët sipas letrës standarde të AK janë të përgjegjshëm dhe janë më të lirë se ankuesi, andaj mbi bazën e të dhënave si më lartë OE ankues është palë pa interes juridiko-material. Në nenin 111 të LPP-së përcakton se kur duhet të merren masa OSHP-ja për një ankesë të dorëzuar. Në paragrafin 1.5. dhe 1.8 përcaktohen ndër të tjera dy kritere që duhet përmbushur për tu shqyrtuar një ankesë e ato janë: 1.5.vërtetohet se parashtruesi i ankesës kualifikohet si “palë e interesuar” siç është përkufizuar kjo shprehje në nenin 4 të këtij ligji; 1.8.përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës në raste kur ankuesi përfshin pretendimin për kompensim.

Andaj Paneli shqyrtues bazuar në konstatimin e ekspertit shqyrtues që ankuesi është “ Palë pa interes juridiko-material” nuk lëshohet në konstatimet e pretendimeve ankimore ndaj të rekomanduarit për kontratë për shkak se pala ankimore nuk ka provuar se është palë me interes, Autoriteti kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit, me datën 05.09.2025, përmes, Letres Standarde për 6 tenderuesin e pasuksesshem e ka njoftuar ankuesin në mënyre të detejaur për rezultatin e procesit të vlerësimit. Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK-së lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale

për vlerësimin e kryer të ofertës, rrjedhimisht pasi që Paneli shqyrtues ka konstatuar se AK e ka kualifikuar ankuesin të përgjegjshëm por të pasuksesshëm si dhe në bazë të vendimit të AK edhe letrave standarde OE është renditur si OE i 6 (gjashti) duke i pasur edhe 4 (OE) tjerë të cilët edhe ata gjithashtu janë renditur si përgjegjshëm por të pasuksesshëm në këtë aktivitet të prokurimit dhe për asnjërin prej tyre nuk ka paraqitur pretendime ankimore kundrejt tyre dhe për të provuar pa përgjegjësin e tij, por i njëjti ka paraqitur vetëm pretendime ankimore ndaj OE të rekomanduar për kontratë, andaj edhe për Panelin Shqyrtues sikurse Eksperti shqyrtues ankuesi në këtë rast kualifikohet si pale pa interes interes juridiko-material sipas nenit 4.1.26 të LPP, ngase të njëjtit në nuk kanë arritur të dëshmojnë se mund të jetë fitues potencial të kësaj kontrate publike. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Për këto raste të ngjashme OSHP më dt. 09.02.2023, ka publikuar në ueb faqen e saj "Njoftim për Operatoret ekonomik" se si do të trajtohen në rast se nuk respektohen këto parime dhe nuk mund ta kenë pastaj statusin e palës me interes. Këtë vendim Paneli shqyrtues e mbështet edhe tek neni 31, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20. Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritë të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të nenit 111, të LPP.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit të anekses dhe procedurës së prokurimit në kontekstin shpjegimeve si më sipër, ankuesin e cilëson si palë pa interes juridik material, ku nder të tjera paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 103 të LPP, sipas të cilit, "Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 të këtij ligji". Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin se ankesa hedhet e palejuar, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatorët ekonomik ankues, bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP. Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundur, të drejtë, pa diskriminim, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Agjencia Qendrore e Prokurimit**
- **OE - "Internat Security Association" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: